

VENDIM
Nr. 19, datë 22.4.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, neni 15, neni 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të mbarimit të afatit dhe shtim të kategorisë D, operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Durrës me:

Drejtues ligjor	Doklead Ademi
Drejtues teknik	Franc Stajka
Drejtues teknik	Daut Kuke

2. Operatori sh.a. UK Durrës autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

Kategoria D, për përpunimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e mbulimit të këtij operatori është: Bashkitë: Durrës, Shijak, Vorë, Sukth, Manëz.

Komunat: Prezë, Maminas, Gjejalaj, Katund i Ri, Fushë-Kuqe, Bupq, Ishëm, Thumanë, Xhafzotaj, Rrashbull.

4. Afati i vlefshmërisë së licencës për kategoritë A dhe C është 4 vjet deri në datën 21.4.2017. Afati i vlefshmërisë për kategorinë D është 1 vit deri më 21.4.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi